

Shërbimet mbështetëse

Ekzistojnë një numër shërbimesh falas që ju ndihmojnë me mbështetje, këshillë dhe ndihmë praktike duke ju mundësuar që të qëndroni në shtëpinë tuaj. Ato gjithashtu ndihmojnë me këshillë financiare, aplikimet për ndihma, për të bërë shokë, për të gjetur aktivitete të lira, për të vënë kontakt me njerëzit lokalë, për të gjetur mjek familjeje, mbi çështje strehimi, imigracioni, trajnim dhe punësim, çështje shkolle dhe kujdesi fëmijësh, si dhe shërbime tjera lokale.

Edhe pse shërbimet do të përfaqësojnë dhe flasin në emër të individëve, qëllimi i tyre është që të rrisin vetëbesimin e tyre dhe në fund t'ju mundësojnë individëve që të menaxhojnë jetët e tyre pa mbështetje. Shërbimi viziton njerëzit në shtëpitë e tyre dhe gjithashtu mbështet njerëzit që presin të lirohen nga spitali, duke rregulluar çështje praktike për të mundësuar tranzicion të lehtë nga spitali në shtëpi.

Nëse ju duhen shërbime përkthimi apo informata në gjuhë të ndryshme, ne do të jemi të kënaqur që t'ju sigurojmë këto.

Financuar nga Mbështetja e Njerëzve (*Supporting People*), shërbimet udhëhiqen nga organizata të sektorit vullnetar.

Si të qasni shërbimet mbështetëse

Ju mund t'i kontaktoni ato direkt me telefon apo letër, apo profesionisti i kujdesit social apo shëndetësor mund të bëjë referimin në emrin tuaj. Ata do t'ju pyesin për emrin tuaj, adresën, datëlindjen, arsyen për kërkesë dhe ndonjë nevojë përkthimi.

Ku gjenden shërbimet

Për meshkuj dhe femra të moshës 60 vjeç e sipër

(60+ në Haringey)

60+ in Haringey

Block 27F, Units 3/4/5/6

N17 Studios

784-788 High Road

Tottenham N17 0DA

Tel: 0800 652 610

Jemi hapur çdo ditë nga 9.00 – 21.00.

... vazhdon/ ...

Support services (Albanian)

Për të rritur të moshave 16-65 vjeç, beqarë dhe çifte:

(Mbështetja Kyçe)

Key Support

7 Willoughby Road

London N8 0HR

Tel: 020 8347 2327

Fax: 020 8348 0418

Email: keysupport@communityhousing.org.uk

Shërbimi ka qasje për njerëz me paaftësi dhe orari ynë i punës është nga e Hëna deri të Premte në orët 9.00 – 17.00.

Për familjet me fëmijë:

(HARTS për Familje (Mbështetja e Qiraxhinjve Haringej))

HARTS (Haringey Tenancy Support) for Families

1-7 Corsica Street

London N5 1JG

Tel: 0845 303 2350

Fax: 020 8826 1701

Email: harts@circle33.org

Shërbimi ka qasje për njerëz me paaftësi dhe orari ynë i punës është nga e Hëna deri të Premte në orët 9.00 – 17.00.